



Prishtinë: 06.04.2020
Kodi i ZRRE-së: V_1245_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2031_01_20**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **21.02.2020**.

në seancën e mbajtur më datë 06.04.2020, nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Sh.K. nga fshati Muzeqinë, Shime si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II. **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_2031** i datës 31.01.2020.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 21.02.2020 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori Sh. K. i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se vendimi nuk ka dhënë asnjë detaj të bazuar, por vetëm ka bërë vlerësimin e rastit. Konsumatori në ankesë ka theksuar se nuk është e vërtetë se në periudhat 12/2016 dhe 01/2017 kemi lexim dhe faturim paushall. Konsumatori ka theksuar se në janar 2017 ka bërë një pagesë dhe borxhi është bërë zero por që menjëherë pastaj ka ardhur fatura 84.74€, dhe se korrigjimi i kësaj është 71.37 € sikur konsumatori për atë muaj të ketë atë shpenzim. Konsumatori ka theksuar se faturat e tij zakonisht sillen diku rreth 18 – 30€ dhe se nuk ka pajisje që bënë atë shpenzim të faturuar.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 06.04.2020 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se vendimi nuk ka dhënë asnjë detaj të bazuar, por vetëm ka bërë vlerësimin e rastit, Bordi i ZRRE thekson se vendimi i organit të shkallës së parë është plotësisht i saktë dhe i bazuar në dispozita ligjore të legjislacionit primar të sektorit të energjisë dhe në dispozita të legjislacionit sekondar. Për më tepër Bordi i ZRRE thekson se çdo konstatim i potencuar në vendimin e organit të shkallës së parë është i bazuar në provë konkrete, dhe se vendimi i organit të shkallës së parë është i bazuar në disa konstatime, duke filluar nga procesverbali i inspektimit nr.2238069 i datës 02.03.2017, në të cilën procesverbal shihet qartë se gjendja e shpenzimit të



energjisë elektrike e njehsorit elektrik nr.16071233 prej TL=005425 kWh dhe TU=002245 kWh e evidentuar në procesverbal përputhet me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike aktive të evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike aktive të periudhës 02/2017 dhe 03/2017. Konstatim tjetër i bërë në vendimin e organit të shkallës së parë të ZRRE është se nuk ka ndryshim të shpenzimit të energjisë elektrike gjatë krahasimit të shpenzimeve të energjisë elektrike të periudhës para dhe pas periudhës kontestuese për periudha të njëjta kohore

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se nuk është e vërtetë se në periudhat 12/2016 dhe 01/2017 kemi lexim dhe faturim paushall, Bordi i ZRRE thekson se kjo nuk qëndron pasi bazuar në rrjedhën e energjisë elektrike aktive dhe transaksioneve të konsumatorit vërehet se konsumatori ka lexim dhe faturim të saktë pikës matëse, përveç prej periudhës 12/2016 deri më 02/2017, ku në periudhën 12/2016 dhe 01/2016 kemi lexim dhe faturim pa matje/paushall dhe atë me shpenzim të faturuar prej 283 kWh për muaj, ndërsa në periudhën 02/2017 kemi grumbullim të shpenzimit të këtyre periudhave prej 1,011 kWh. Pra ky faturim i shpenzimit të energjisë elektrike është i pamohueshëm nga ana e konsumatorit pasi që kjo lehtë është e vërtetueshme përmes rrjedhës së energjisë elektrike dhe transaksioneve të konsumatorit.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se në janar 2017 ka bërë një pagesë dhe borxhi është bërë zero por që menjëherë pastaj ka ardhur fatura 84.74€, dhe se korrigjimi i kësaj është 71.37 € sikur konsumatori për atë muaj të ketë atë shpenzim, Bordi i ZRRE thekson se ashtu siç theksuam më lartë konsumatori në periudhën 12/2016 është faturuar pa matje/paushall me shpenzim prej 283 kWh apo llogaritur në vlerë financiar prej 19.07€, pastaj në periudhën 01/2017 është faturuar pa matje/paushall me shpenzim prej 283 kWh apo llogaritur në vlerë financiar prej 19.07€, dhe tek pastaj në periudhën 02/2017 është faturuar pa matje/paushall me shpenzim prej 1,011 kWh apo llogaritur në vlerë financiar prej 84.84€, e që shihet qartë se kemi të bëjmë me faturim pa matje/paushall për periudhat 12/2016 dhe 01/2017 dhe me grumbullim të shpenzimit për periudhën 02/2017. Bordi i ZRRE ka vërejtur se është e saktë që konsumatori me datë 07.02.2017 ka bërë një pagesë prej 30.00€, por që pastaj ka ardhur fatura e muajit 02/2017. Gjithashtu Bordi i ZRRE thekson se është analizuar me kujdes korrigjimi plotësues i bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO me datë 07.03.2017 dhe konstaton se korrigjimi i KESCO është i saktë dhe konform nenit 28, paragrafi 3 i Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, e në të cilën thuhet se: “Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se faturat e tij zakonisht sillen diku rreth 18 – 30€ dhe se nuk ka pajisje që bënë atë shpenzim të faturuar, Bordi i ZRRE thekon se gjatë analizës së bërë shpenzimit të energjisë elektrike të konsumatorit gjatë periudhës kontestuese 12/2016 – 02/2017 me periudhat e njëjta para dhe pas kësaj periudhe konstatohet se nuk ka ndryshim të shpenzimit të energjisë elektrike mes këtyre periudhave kohore. Duhet theksuar se mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike prej periudhës kontestuese 12/2016 – 02/2017 është 525.33 kWh/muaj (pas shpërndarjes proporcionale të shpenzimit të energjisë elektrike bërë nga KEDS-i gjatë korrigjimit), mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike prej periudhës 12/2015 – 02/2016 është 347.33 kWh/muaj dhe se mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike prej periudhës 12/2017 – 02/2018 është 590.00 kWh/muaj. Pra shihet qartë se nuk ka ndryshim të shpenzimit të energjisë gjatë periudhës kontestuese, me periudhat tjera kohore para dhe pas. Andaj Bordi i ZRRE thekson se vendimi i organit të shkallës së parë për refuzimin e ankesës së konsumatorit është i saktë, i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë



dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 06.04.2020 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit Sh.K.
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.